



Përmbledhje mbi projektin: “Krijimi i Programit Master në Kriminologji”

2019-2024
zbatuar nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri

Financuar nga Buroja e Çështjeve Ndërkombëtare të Narkotikëve
dhe Zbatimit të Ligjit (INL) e Departamentit të Shtetit të SHBA-së,
Misioni i SHBA-së në OSBE, Ambasada Britanike në Tiranë dhe Qeveria e Italisë

Qëllimi i projektit ishte të krijohet një strukturë e qëndrueshme e kërkimit dhe mësimdhënies shumëdisiplinore në Kriminologji në Shqipëri, duke përmirësuar kështu kapacitetet dhe burimet e profesionistëve të drejtësisë penale, akademikëve dhe politikëbërësve në vend, për të parandaluar dhe luftuar krimin si dhe për t'iu përgjigjur nevojave të viktimave të krimit, në përputhje me standardet e të Drejtave të Njeriut dhe angazhimet e OSBE-së.

Projekti u zbatua në bashkëpunim të ngushtë me Fakultetin e Drejtësisë të Universitetit të Tiranës, me mbështetje nga Fakulteti i Shkencave Sociale, Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Brendshme.

Programi Master në Kriminologji është programi i parë i Masterit Ekzekutiv në Shqipëri, i përfshirë në ciklin e tretë të studimeve, i krijuar në Fakultetin e Drejtësisë, Universitetin e Tiranës.

Përmes programit master, Prezenca kishte si qëllim përmirësimin e kapaciteteve kërkimore të profesionistëve, akademikëve dhe politikëbërësve në Shqipëri për të identifikuar shkaqet thelbësore të krimit. Kërkimi kriminologjik qëndron në thelb të teorisë kriminologjike, ndikon në zhvillimin e politikave sociale, publike dhe të sigurisë, si dhe kontribuon në praktikën e drejtësisë penale.

Krijimi i këtij programi master është një histori suksesi, pasi ka një interes gjithnjë e më të lartë nga praktikuesit e ligjit për këtë program. Studentët e regjistruar në program vijnë nga një gamë e gjerë fushash, kryesisht nga agjencitë e zbatimit të ligjit, përfshirë oficerë të policisë gjyqësore, oficerë policie, avokatë mbrojtës, lektorë të Akademisë së Sigurisë, përfaqësues të OJQ-ve, ekspertë të drejtësisë penale, etj.

Masteri Ekzekutiv në Kriminologji është projektuar për të përmirësuar kapacitetet kërkimore të profesionistëve të drejtësisë penale, akademikëve dhe politikëbërësve në vend, në parandalimin dhe luftimin e krimit, si dhe në përgjigjen ndaj nevojave të viktimave të krimit, në përputhje me standardet e të Drejtave të Njeriut. Projekti mbështeti një bashkëpunim të shtuar ndërmjet akademisë dhe agjencive të zbatimit të ligjit, duke theksuar se si kërkimi mund të kontribuojë në punën e praktikuesve të ligjit, që në vetvete përbënte një nga qëllimet e projektit.



British Embassy
Tirana



Pas më shumë se pesë vitesh punë intensive, angazhimi i OSBE-së përfshiu zhvillimin e strukturës dhe kurrikulës për Programin Master, trajnimin e stafit akademik, ndërtimin e lidhjeve me institucionet partnere, si dhe forcimin e kapaciteteve dhe burimeve të Universitetit të Tiranës për të ofruar dhe menaxhuar një program kaq kompleks dhe, përfundimisht, të suksesshëm. Disa nga arritjet kryesore të Programit Master përfshijnë:

Krijimi i strukturës së Programit Master në Kriminologji

- U krijua Struktura e Programit Master në Kriminologji.
- Në vitin 2019 u krijua një Bord Akademik për Programin Master në Kriminologji.
- U zhvillua një kurrikulë e detajuar për çdo modul, duke u bazuar në modele ndërkombëtare të ngjashme për programe të tilla master. Në total, programi ka 20 module (120 ECTS).
- U zhvilluan takime të grupeve të punës për zhvillimin dhe implementimin e Programit Master, ku morën pjesë partnerë akademikë, ekspertë, Fakulteti i Drejtësisë dhe aktorë të tjerë.
- U rishikua kurrikula e Programit Master.

Ndërtimi i kapaciteteve

- Ndërtimi i kapaciteteve të Universitetit të Tiranës për të menaxhuar programin, përmes trajnimeve për stafin akademik, mundësive për shkëmbim përvojash për lektorët dhe pjesëmarrjes në takime/konferenca tematike, si në Universitetin e Cambridge, Universitetin e Oxford, Universitetin e New Haven, John Jay College në New York, Universitetin LUISS në Romë, Universitetin e Pavia, Universitetin Democritus të Trakës, Universitetin e Sassari, Centro Studio, Alta Formazione e Ricerca Italo-Albanese del CEMAS në Universitetin Sapienza të Romës, dhe institucione të tjera.
- Sigurimi i literaturës së nevojshme, materialeve të përkthyer dhe materiale leximi për programin master, përfshirë aksesin online në biblioteka ndërkombëtare, duke përfutur si lektorët, edhe studentët për qëllime mësimdhënie dhe studimi.
- Organizimi i disa konferencave akademike ndërkombëtare dhe kombëtare, workshopeve dhe seminareve.

Rritja e ndërgjegjësimit dhe informimi

- Rritja e ndërgjegjësimit të përfituesve të synuar për programin master.
- Projekti mbështeti shpërndarjen e informacionit në rajonin dhe komunitetin e synuar për të rritur ndërgjegjësimin mbi aspektet kyçe të programit.

Qendra për Kërkime dhe Publikime në Kriminologji

- U krijua Qendra për Kërkime dhe Publikime në Kriminologji, me qëllim zhvillimin e lidhjeve akademike dhe kërkimore dhe forcimin e kapaciteteve të mësimdhënies dhe kërkimore në Universitetin e Tiranës.
- Projekti kontribuoi në ndërtimin e infrastrukturës dhe pajisi Qendrën Kërkimore me pajisje zyrash dhe pajisje informatike të nevojshme për funksionimin e Qendrës.
- Për të mbështetur plotësisht kapacitetet e Qendrës Kërkimore, projekti mundësoi rreth 30 punime kërkimore në fushën e Kriminologjisë. Kërkimet e kryera përdoren nga stafi akademik dhe studentët e programit Master në Kriminologji. Përveç kësaj, ato do të ndihmojnë Qendrën Kërkimore në Kriminologji, pasi kërkimet e kryera do të përdoren për udhëheqjen e politikave të drejtësisë penale në Shqipëri.
- Përmes kësaj qendre, kërkimet e kryera do të kalojnë në kontroll cilësie dhe do të jenë në përputhje me kuadrin ligjor, për të ofruar analiza të duhura mbi shkaqet themelore, modelet, faktorët nxitës të krimit dhe parandalimin e tij.

Programi (Fellowship)

- Krijimi i një programi (fellowship) për të mbështetur Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë e Punëve të Brendshme në fushat e kërkimit.
- Punime kërkimore mbi tema si ndikimi i mediave sociale në politikat kriminale, burgosja e grave shtatzëna, profilet krimnologjike, nëna surrogate dhe trafikimi i qenieve njerëzore, si dhe parricidi në shoqërinë shqiptare.

Programi master u lançua në dhjetor 2020, kur brezi i parë i studentëve filluan studimet e tyre.

52 studentë kanë përfunduar me sukses studimet deri në dhjetor 2024.

Overall, about 1,000 participants from courts, prosecution offices, law enforcement agencies, local government, students, and other institutions took part in these awareness-raising events. During the events, there was strong interest among participants in registering for this Master's programme.

Që nga fillimi i programit në dhjetor 2020, gjithsej 190 studentë janë regjistruar për programin master.

Programi u akreditua nga Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve në vitin 2023.